

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Sigurimi i jetës dhe shëndetit për punonjësit e OST sh.a.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

66511000-5 - Shërbime të sigurimit të jetës

VLERA E FONDIT LIMIT:

19,195,000 (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 198,438.95 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 02.10.2025 (1 EUR = 96.73 Lekë).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt “Sigurimi i jetës dhe shëndetit për punonjësit e OST sh.a.”, ka për qëllim të garantojë mirëqënien dhe sigurinë e punonjësve në ambientet e tyre të punës, gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre.

Duke vlerësuar rëndësinë e shëndetit dhe jetës së punonjësve të AK, si dhe duke vlerësuar minimizimin e riskut financiar, ka vendosur të vazhdojë të mundësojë sigurimin e jetës dhe shëndetit, për kategorinë e punonjësve të ekspozuar në mënyrë më të madhe ndaj rreziqeve, siç është kategoria e punonjësve të sektorit të mirëmbajtjes së linjave, kategoria e punonjësve të sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve si dhe për punonjëset femra të OST sh.a., me qëllim parandalimin e sëmundjeve të ndryshme.

Fondi limit i kësaj procedure ka rezultuar mbi kufirin e larte monetar, për shkak të numrit të punonjësve që do të përfitojnë nga ky shërbim.

Ndarja në lote dhe lidhja e mundshme e kontratave me operatore ekonomike të ndryshëm, mund të krijojë edhe mospërputhje të kryerjes së shërbimeve shëndetësore objekt kontrate, pasi analizat dhe kontrollet e nevojshme do të realizoheshin në qendra të ndryshme shëndetësore.

Për këto arsye, AK nuk mund të ndajë në lote këtë procedure prokurimi.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, të paktën 38,000,000 (tridhjetë e tetë milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine e shërbimeve objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar

ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros duhet te jete ne masen 38,000,000 (tridhjetë e tetë milion) Leke.

2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 7,000,000 (shtatë milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën afërsisht 40 % të vlerës së fondit limit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë ne konsiderate sasine dhe cilesine e shërbimeve objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afërsisht 40 % të vlerës te fondit. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues, ne perputhje me Ligjin Nr. 52, date 22.05.2014 “Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit”, duhet te jete i licencuar nga AMF (Autoriteti i Mbiqyrjes Financiare) per ushtrimin e veprimtarise ne klasen 1 – Sigurimi i Aksidenteve, klasen 2 – Sigurimi i Semundjeve dhe/ose klasa 19 - Sigurimi i jetës. Per te permbushur kete kriter, OE ofertues duhet te paraqese licencen me kategorite perkatese.*

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. Licencimi i OE ofertues për të ofruar shërbimin objekt kontrate është në zbatim të Ligjit Nr. 52, date 22.05.2014 “Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit”, sipas kategorive përkatëse për të cilat do të realizohet kontrata. Ky kriter është vendosur mbështetur në nenin 41/4/a, te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Nenin 77, pika 2, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje vetedeklarim, ku te specifikojë se merr persiper dhe pranon, si me poshte vijon:*

- a) *Kompania e sigurimit të jetë e licensuar nga AMF për ushtrimin e veprimtarisë në klasën 1 – Sigurimi i Aksidenteve, klasën 2 – Sigurimi i Sëmundjeve dhe/ose klasa 19 - Sigurimi i jetës.*
- b) *Të ofrojë mbulimin për shërbimin spitalor, me garanci pagese (pa paguar i siguruari)*
- c) *Të paraqesë metodën që aplikon cdo i siguruar për gjurmimin e kërkesave për rimbursim në mënyrë që personi i siguruar të ketë transparencë të procesit të rimbursimit*
- d) *Të paraqesë procedurën e organizimit të shërbimit pa pagesë kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;*
- e) *Të paraqesë procedurën e rimbursimit të shërbimit kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;*
- f) *Ne rast emergjence te siguruarit nuk duhet te refuzohet shërbimi ne rrjetin mjekësor te Siguruesit, me paraqitjen e kartes se sigurimit. Ne raste jo emergjente shërbimi me garanci pagese nga Siguruesi ofrohet pasi eshte dakorduar midis te siguruarit dhe siguruesit.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të ketë përgjegjësitë përkatëse për sigurimin e jetës dhe shëndetit për punonjësit, sipas përshkrimit të Termave të Referencës objekt procedure prokurimi. OE ofertues duhet të ketë të qartë se do të marrë përsipër riskun në rastin e evidentimit të nevojës që punonjësit e AK të kenë nevojë për mbulim spitalor apo shëndetësor, sipas përshkrimeve ne Termat e Referencës dhe Dokumentet e Tenderit.

2.3.4 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 10 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratores te shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.